



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

KONVENTA E NIKOZISË, PËRQASJA NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Erlanda Agaj *

** Magjistrate, profili Gjyqtare , Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithsëm, Tiranë*

Përmbledhje

Punimi synon të trajtojë detyrimet e ligjvënësit shqiptar që burojnë nga Konventa e Këshillit të Evropës për veprat penale që lidhen me pronën kulturore, miratuar në Nikosia më 19 maj 2017, që njihet si “Konventa e Nikozisë”. Në cilësinë e traktatit të parë ndërkombëtar dedikuar për kriminalizimin e veprave penale kundër trashëgimisë kulturore, Konventa e Nikozisë plotëson boshllëqet e lëna nga konventat e mëparshme, dhe veçanërisht vë në jetë qëllimet e shprehura, por të paarritura nga Konventa e Delfit e 1985-ës. Punimi synon të nxjerrë në pah shtrirjen e kufizuar të praktikës gjyqësore shqiptare, në ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve kundër pronës kulturore. Referuar të dhënave konkrete të viteve 2011–2023, konstatohet se përgjatë këtyre viteve gjatë janë regjistruar 121 raste, por janë përfunduar vetëm me 24 autorë të dënuar. Ratifikimi i Konventës së Nikozisë, ka një rëndësi të madhe pasi Shqipëria duhet të hartojë një strategji dhe plan veprimi të mirëfilltë për të penalizuar një sërë veprimesh që prekin trashëgiminë kulturore, në funksion të hartimit të akteve konkrete ligjore. Synimi parësor duhet të jetë miratimi i dispozitave të hollësishme ligjore për të siguruar zbatimin e tyre efektiv. Këtu përfshihet harmonizimi i legjislacionit në lidhje me veprat penale të trashëgimisë kulturore, me standardet ndërkombëtare. Arritja e harmonizimit të legjislacionit do të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e praktikave gjyqësore dhe rritjen e kapaciteteve midis organeve të zbatimit të ligjit dhe praktikuesve të së drejtës. Zbatimi i Konventës do të forcojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, duke rritur numrin e çështjeve të hetuara dhe gjykuara, njëkohësisht duke forcuar angazhimin e vendit ndaj detyrimeve të tij ndërkombëtare dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore globale.

Fjalë çelës: *konventa e Nikozisë, trashëgimia kulturore , krime kundër pronës kulturore, përgjegjësia penale ,pasuri kulturore*

THE NICOSIA CONVENTION: ALIGNMENT WITH ALBANIAN LEGISLATION

Abstract

This paper examines the obligations of Albanian lawmakers under the Council of Europe Convention on Offences Relating to Cultural Property, adopted in Nicosia on May 19, 2017, and commonly referred

to as the “Nicosia Convention.” As the first international treaty dedicated to the criminalization of offenses against cultural heritage, the Nicosia Convention addresses gaps left by earlier instruments, particularly the unfulfilled objectives of the 1985 Delphi Convention. The paper underscores the limited scope of Albanian judicial practice in prosecuting and adjudicating crimes against cultural property. Between 2011 and 2023, 121 cases were registered, yet only 24 perpetrators were convicted. The entry into force of the Nicosia Convention represents a step forward, requiring Albania to develop a comprehensive strategy and action plan to criminalize a broader spectrum of offenses against cultural heritage and to facilitate the drafting of concrete legal instruments. A key focus should be the adoption of detailed legal provisions to ensure effective implementation, including the alignment of domestic legislation with international standards on cultural heritage offenses. Legislative harmonization will directly impact the improvement of judicial practices and enhance the capacity of law enforcement authorities and legal practitioners. Implementing the Convention will strengthen the legal protection of Albania’s cultural heritage by increasing the number of investigated and adjudicated cases. Moreover, it will reaffirm Albania’s commitment to its international obligations and contribute to the preservation of global cultural heritage.

Keywords: *Nicosia convention, cultural heritage, crimes against, cultural property, criminal liability, cultural heritage assets*

1. Qëllimi i miratimit të Konventës së Nikozisë

Konventa e Nikozisë është miratuar dhe hapur për nënshkrim në datën 19.05.2017 dhe aktualisht është e nënshkruar nga 14 (katërmëdhjetë) shtete, 7 (shtatë) prej të cilave e kanë ratifikuar atë. Konventa ka hyrë në fuqi në datën 01.04.2022, pasi u depozitua instrumenti i pestë i ratifikimit. Shtetet që kanë nënshkruar Konventën janë: Shqipëria, Armenia, Qipro, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Mal i Zi, Portugalia, San Marino, Sllovenia, Ukraina, Meksika dhe Rusia. Shtetet që e kanë ratifikuar Konventën janë Qipro, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Meksika¹ dhe së fundmi, në datën 19 dhjetor 2024 është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1 të datës 7 janar 2025, dhe ligji për ratifikimin e saj, nr. 123/2024 hyn në fuqi në datën 22 janar 2025.² Vetë konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit tri muaj, pasi të depozitohet instrumenti i ratifikimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës³.

Konventa shoqërohet edhe nga një Raport Shpjegues⁴, i përgatitur nga hartuesit e Konventës, me qëllim që të jetë e kuptueshme nga lexuesit dhe zbatuesit e saj. Raporti Shpjegues nuk është autoritet kryesor i detyrueshëm, por ka natyrën e një autoriteti dytësor bindës. Kur ka një autoritet të detyrueshëm dhe ka një autoritet bindës dytësor, autoriteti dytësor mund të përdoret për të mbështetur autoritetin parësor⁵.

Nga lista e shteteve nënshkruese, del në pah, një nga veçoritë e para të Konventës. Pavarësisht se është një Konventë e Këshillit të Evropës, i cili përbëhet nga 46 (dyzet e gjashtë) shtete të Kontinentit

1 <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatyenum=221> (Aksesuar në datën 14.01.2025)

2 Shih Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, nr.1, datë 7 janar, të vitit 2025, në Qendrën e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2025> (Aksesuar në datën 14.01.2025)

3 Neni 27 paragrafi i katërt i Konventës së Nikozisë

4 “Council of Europe Convention on offences relating to cultural property, CETS No. 221 and explanatory report”, Nicosia 19.V.2017, Council of Europe, March 2022 <https://rm.coe.int/council-of-europe-convention-on-offences-relating-to-cultural-property/1680a5dafb> (Aksesuar në datën 15.01.2025)

5 Sokol Berberi, “Arsyetimi dhe shkrimi ligjor”, Tiranë 2011, Shtypshkronja “MORAVA”, faqet 17-24.

vropian⁶, Konventa është nënshkruar nga Rusia dhe Meksika, duke u ratifikuar nga kjo e fundit. Pra, Konventa është e hapur për të gjitha shtetet pavarësisht kontinentit ku janë pozicionuar gjeografikisht, sepse krimet ndaj trashëgimisë kulturore, janë shqetësim i të gjithëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁷ ka mbajtur qëndrimin se, në lidhje me veprat e artit të artistëve të huaj, që ndodhen në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti dhe që i përkasin trashëgimisë kulturore të të gjitha kombeve, është legjitime që një shtet të marrë masa të synuara për të lehtësuar, në masën më të madhe në mënyrë efektive, akses të gjerë publik ndaj tyre, në interes të përgjithshëm të kulturës universale.

Qëllimi i Konventës së Nikozisë është: të parandalojë dhe të luftojë shkatërrimin, dëmtimin dhe trafikimin e pasurive kulturore, duke parashikuar kriminalizimin e disa akteve; të forcojë parandalimin e krimit dhe kundërpërgjigjen e drejtësisë penale për të gjitha veprat penale që lidhen me pasuritë kulturore; të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në luftën kundër veprave penale që lidhen me pasuritë kulturore; dhe si rrjedhojë të mbrojë pasuritë kulturore.⁸

2. Ndikimi i Konventës së Nikozisë në legjislacionin shqiptar

Projekti evropian filloi me një këndvështrim të integritetit të bazuar në “mbikombëtarizmin”. Ishte pretendimi i shteteve për sovranitet që u konsiderua si shkak kryesor i konfliktit në Evropë.⁹ Qëllimi i Këshillit të Evropës, sipas nenit 1 të statutit të tij, është “*të realizojë një lidhje më të ngushtë mes anëtarëve të tij për të ruajtur dhe zhvilluar idealet dhe parimet, të cilat janë pasuria e përbashkët e tyre dhe të nxisë përparimin ekonomik dhe shoqëror*”. Këshilli i Evropës i realizon këto qëllime në një numër të madh sektorësh, me përjashtim të mbrojtjes kombëtare, por duke përfshirë trashëgiminë kulturore, ku e drejta penale dhe procedural penale janë të pranishme, në kushtet e rritjes së kriminalitetit ndërkufitar.¹⁰ Megjithatë, një e drejtë penale evropiane ka pasur kundërshtarët dhe partizanët e saj, pasi sovraniteti i shteteve dhe veçoritë kombëtare të së drejtës penale kanë qenë argumentat kundër një të drejte penale të përbashkët.¹¹ Pavarësisht kësaj, Këshilli i Evropës, në vitin 2017, mori nismën në Nikozi në Qipro, të vijonte dhe zëvendësonte¹² projektin e papërfunduar të Konventës së vitit 1985 të Delf-it, e cila nuk hyri asnjëherë në fuqi pasi nuk u ratifikua nga shtetet¹³, duke miratuar Konventën e Nikozisë. Kjo e fundit, mund të konsiderohet si traktati i vetëm ndërkombëtar, i cili ka për objekt kriminalizimin e veprave penale që lidhen me trashëgiminë kulturore, duke plotësuar boshllëqet e konventave të tjera në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.¹⁴

Kuadri ligjor shqiptar në lidhje me trashëgiminë kulturore në Shqipëri, është zhvilluar në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në organizma ndërkombëtarë të fokusuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe nisur nga nevoja për të luftuar veprimet dhe mosveprimet e paligjshme ndaj veprave të artit dhe kulturës brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sa i takon praktikës gjyqësore, ajo ka qenë e paktë dhe nga ana e organeve ligjzbatuese, veprat penale

6 <https://www.coe.int/en/web/portal/46-members-states> (Aksesuar në datë 14.01.2025)

7 Beyeler kundër Italisë ([GC], nr. 33202/96, GJEDNJ 2000-I), paragrafi 113.

8 Shih nenin 1 të Konventës së Nikozisë.

9 Leonard F.M Besselink, “*Identiteti kombëtar dhe kushtetues para dhe pas Lisbonës*”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 4, Viti XV i botimit, Tiranë, dhjetor 2014, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “MORAVA”, faqja 135.

10 Jean Pradel, Geert Corstens, Gert Vermeulen, “*E drejta penale evropiane*”, 2009, Botimet Papirus, faqja 47.

11 Po aty, faqja 12.

12 Shih preambulën e Konventës së Nikozisë.

13 Konventa Evropiane mbi veprat penale të lidhura me pasuritë kulturore, Delfi, 23.06.1985.

14 Mateusz Maria Bieczyński, “*The Nicosia Convention 2017: A New International Instrument Regarding Criminal Offences against Cultural Property*”, Santander Art and Culture Law Review 2/2017 (3): 255-274 DOI: 10.4467/2450050XSNR.17.017.8432, faqja 263. (Aksesuar më datë 14.01.2025 [SAACLR nr 2_2017_\(3\)_16\(2\).pdf](#))

në fushën e trashëgimisë kulturore, janë konsideruar si krime jo serioze. Referuar statistikave të grumbulluara dhe analizuara nga Raportet e Prokurorit të Përgjithshëm për Gjendjen e Kriminalitetit¹⁵, në periudhën 2011-2023 janë regjistruar gjithsej 121 (njëqind e njëzet e një) procedime penale që lidhen me veprat penale që kanë për objekt mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe janë dënuar 24 (njëzet e katër) persona. Edhe në ato raste kur procedimi penal ka përfunduar me vendim për deklarimin fajtor të të pandehurit, vihet re se përgjithësisht aplikohet lloji i dënimit me gjobë¹⁶; minimumi i dënimit me burgim që parashikon dispozita, nga 3 (tre) muaj¹⁷ në rastin e vjedhjes; në 3 (tre) vjet burgim në rastin e trafikimit¹⁸; si dhe në disa raste vendoset pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit me provë, konform nenit 59 të Kodit Penal¹⁹. Kjo mund të ketë ardhur edhe për shkak të mangësive në Kodin Penal shqiptar sa i takon veprimeve dhe mosveprimeve, si dhe mungesës së një parashikimi të caktuar kur vepra kryhet nga subjekte të posaçëm, të cilët për shkak të detyrës apo profesionit e kanë më të lehtë kryerjen e krimit. Megjithëkëtë, me ratifikimin e “Konventës së Këshillit të Evropës për Veprat penale që lidhen me pasurinë kulturore” bërë në Nikozi datë 19 Maj 2017 (në vijim “Konventa e Nikozisë”), shteti shqiptar duhet të kriminalizojë një sërë aktesh si vepra penale, krime apo kundërvajtje, duke parashikuar norma penale të detajuara, të qarta, të cilat duke u njohur mirë nga praktikuesit e së drejtës²⁰, do të rrisin numrin e çështjeve të hetuara dhe gjykuara.

2.1. Pasuritë që duhet të mbrohen sipas Konventës së Nikozisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e konsideron trashëgiminë kombëtare si një nga bazat e Shtetit Shqiptar, i cili ka për detyrë t’i respektojë, t’i mbrojë²¹, dhe e konsideron atë si një prej objektivave të saj social. Trashëgimia kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruan në të tashmen, për t’u përçuar brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit²². Kuadri ligjor shqiptar në lidhje me trashëgiminë kulturore në Shqipëri, është zhvilluar në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në organizma ndërkombëtar të fokusuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore²³, si dhe nisur nga nevoja për të luftuar veprimet dhe mosveprimet e paligjshme ndaj veprave të artit dhe kulturës.

Sipas Konventës, pasuritë kulturore janë të luajtshme dhe të paluajtshme. Pasuri kulturore të luajtshme përbën çdo objekt i vendosur në tokë ose nën ujë, ose të hequr prej aty, i cili në qarqe fetare ose laike, klasifikohet, përkufizohet ose përcaktohet në mënyrë specifike nga çdo palë në konventë ose

15 [Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm](#) (Aksesuar në datën 13 Janar 2025)

16 Shih Vendimin nr. 884, datë 15.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

17 Shih Vendimin nr. 13-2015-6585, datë 19.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Vendimin nr. 41-2010-3507, datë 27.09.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; Vendimin nr. 62-2013-4495, datë 30.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

18 Shih Vendimin nr.13-2015-1044, datë 19.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Vendimin nr. 21-2016-992, datë 08.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; Vendimin nr. 11-2014-1571, datë 02.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

19 Shih Vendimin nr. 21-2016-992, datë 08.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; Vendimin nr. 13-2015-6585, datë 19.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

20 Neni 18 i Konventës së Nikozisë, parashikon se secila palë merr në konsideratë marrjen e masave të tjera për të siguruar që personat, njësitë ose shërbimet e ngarkuara me hetime janë të specializuara në fushën kundër luftës së trafikimit të pasurive kulturore ose që kanë marrë trajnimin e duhur

21 Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

22 Pika 59, neni 5 i Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”

23 Shqipëria është bërë pjesë e UNESCO-s në datën 16 Tetor 1958.

në Konventën e vitit 1970 të UNESCO-s për mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore, si me rëndësi për arkeologjinë, parahistorinë, etnologjinë, historinë, letërsinë, artin ose shkencën. Në lidhje me pasuritë e paluajtshme, Konventa përfshin çdo monument, grup ndërtesash, vend ose strukturë e çdo lloji tjetër, qoftë të vendosur në tokë ose nën ujë, i cili në qarqe fetare ose laike, përkufizohet ose përcaktohet në mënyrë specifike nga çdo palë në këtë Konventë, ose nga çdo palë në Konventën e vitit 1970 të UNESCO-s, si me rëndësi për arkeologjinë, parahistorinë, etnologjinë, historinë, letërsinë, artin ose shkencën, ose e renditur në përputhje me nenin 1 dhe nenin 11 (paragrafët 2 ose 4) të Konventës së vitit 1972, të UNESCO-s, në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.²⁴ Siç vihet re, hartuesit e Konventës janë treguar mjaftueshëm të kujdesshëm, duke konsideruar si pasuri kulturore: a) ato pasuri që vetë shtetet anëtare e konsiderojnë, përkufizojnë, klasifikojnë, përcaktojnë si të tillë; b) parashikon vetë kryesisht pasuritë kulturore; referon në akte të tjera ndërkombëtare të Këshillit të Evropës, që kanë objekt mbrojtje pasurinë kulturore. Ky parashikim nga Konventa ka dy qëllime kryesore: së pari, të mos krijohen kontradikta në kuadrin ligjor të shteteve palë në Konventë, dhe së dyti, të garantohet një mbrojtje sa më e gjerë e trashëgimisë kulturore.

2.2. Veprimet dhe mosveprimet që duhet të kriminalizohen sipas Konventës së Nikozisë

Ekzistenca e së drejtës nga ana filozofike kushtëzohet nga papërsosmëria e natyrës së njeriut, nga domosdoshmëria e mbrojtjes, e sigurisë dhe e mirëqënies sociale, nga nevoja e zgjidhjes së konflikteve dhe e garantimit të një rendi normal.²⁵ Kështu, edhe veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme që kanë diktuar nevojën për krijimin e standarteve normative të unifikuara, për t'i konsideruar vepra penale, në raport me ato ekzistuese, në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore janë: veprimet e përvetësimit të sendeve pjesë e trashëgimisë kulturore, gërmimeve, heqjes së paligjshme, importimit të paligjshëm, eksportimit, blerjes apo vendosjes në treg të sendeve të vjedhura/gërmuara/importuar/eksportuar/hequr paligjshëmërisht, shkatërrimi, dëmtimi, apo falsifikimi i dokumenteve që lidhen me pasuritë kulturore.²⁶ Këto veprime, kërkohet që shtetet t'i kriminalizojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm. Sa i takon vendosjes në treg, koncepti “treg” nënkupton edhe tregun e zi, si dhe atë kibernetik (online). Kjo për arsye se, interneti po transformon me shpejtësi mënyrën se si komunikojmë, edukohemi, blejmë dhe shesim të mira dhe shërbime. Megjithatë, ai shërben dhe si një mjet i fuqishëm në duart e personave që kryejnë veprimtari të paligjshme.²⁷ Ndaj, Konventa kërkon që pasuritë kulturore të mbrohen edhe nga ky treg.

Ndonëse shtetet kanë të drejtë të penalizojnë veprimet apo mosveprimet që paraqesin si pasuri kulturore origjinale, ato sende që në fakt nuk janë të tilla, Konventa nuk e parashikon si detyrim. Ndonëse këto aktivitete mund të cenojnë stabilitetin dhe sigurinë e tregut të artit, ato nuk kanë efekt të drejtëpërdrejtë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore²⁸.

Fajësia e autorëve që bëjnë që bëjnë pjesë në zinxhirin e furnizimit normalisht varet nga afërsia e

24 Shih nenin 2 të Konventës së Nikozisë.

25 Kristaq Traja, “*Tipologjia e kuptimeve të së drejtës*”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 2, Tiranë 2018, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “ONUFRI”, faqja 33.

26 Shih nenet 3-10 të Konventës së Nikozisë.

27 Jonad Bara, “*Interneti dhe krimi kibernetik*”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 3, Viti VIII i botimit, Tiranë, shtator 2010, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “MORAVA”, faqja 95.

28 “*The Nicosia Convention in 10 questions and answers*”, botim i Këshillit të Evropës, Mars 2023, faqja 9. <https://rm.coe.int/the-nicosia-convention-in-10-questions-and-answers-/1680aac7f1> (Aksesuar në datën 14.01.2025)

tyre me burimin e mallrave të paligjshëm: më e padiskutueshme do të ishte hallka e parë e zinxhirit. Sidoqoftë, siç vërehet ndonjëherë në lidhje me vjedhjen dhe trajtimin e mallrave të vjedhura, rishitësi ose hallka fundore e zinxhirit i ashtuquajtur në terminologjinë ndërkombëtare *“The fence”* (gardhi rrethues) mund të jetë në disa rrethana një kriminel më serioz, sesa vetë furnizuesi origjinal i mallrave.²⁹ Megjithatë, në vlerësimin e fajësisë së autorëve, Konventa parashikon se duhet të parashikohet në ligjin e brendshëm, se autori duhet t’a ketë ditur ose duhet të provohet se nëse do të kishte treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur në blerjen e pasurisë kulturore, do t’a kishte ditur origjinën e paligjshme të pasurisë kulturore³⁰. Togfjalëshi *“kujdesin dhe vëmendjen e duhur”* i referohet atyre rasteve kur autori, (blerësi apo vendosësi në treg) për shkak të njohurive të tij për shkak të profesionit, detyrës private apo zyrtare, formimit të tij edukativ, ka mundësi të identifikojë një pasuri kulturore, rregullat dhe procedurat që ndiqen lidhur me tregëtimin e tyre. Për shembull, për një muzeolog, arkeolog, specialist marketingu në fushën e artit dhe kulturës, një kurator, koleksionist, është më e lehtë të identifikojë nëse një vepër arti dhe kulture është e vjedhur, nxjerr nga një gjermim, import i paligjshëm. Pra, këto vepra do të konsiderohen të kryera me dashje ose me pakujdesi. Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t’i shmangë ato, ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t’i parashikonte³¹.

2.3. Përgjegjësia penale e personave juridikë sipas Konventës së Nikozisë

Neni 45 i Kodit Penal parashikon se personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre dhe veprat penale, masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë. Mbi bazën e këtij delegimi, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar Ligjin Nr.9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, i cili përcakton rregullat për përgjegjësinë, procedimin penal dhe llojet e masave ndëshkuese që merren ndaj personave juridikë për kryerjen e veprës penale.

Neni 13 i Konventës parashikon se: *“1. Secila palë garanton që personat juridikë të mbajnë përgjegjësi për veprat penale të përmendura në këtë Konventë, kur kryhen për llogari të tyre nga një person fizik duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka pozicion drejtues brenda atij personi juridik, bazuar mbi: a) kompetencën për të përfaqësuar personin juridik; b) autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik; c) autoritetin për të ushtruar kontroll brenda personit juridik. 2. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, secila palë garanton që një person juridik të mbajë përgjegjësi në rastet kur mungesa e mbikëqyrjes apo e kontrollit nga një person fizik i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ka bërë të mundur kryerjen e një veprë penale të përmendur në këtë Konventë për llogari të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.”* Nga përmbajtja e dispozitës, vihet re se hartuesit e Konventës së Nikozisë kanë ndjekur teorinë e identifikimit dhe teorinë e dështimit të menaxhimit, në ngarkimin me përgjegjësi penale të personit juridik në rastin e veprave penale ndaj pasurisë kulturore. Sipas teorisë së identifikimit, nëse një individ i cili është mjaft i lartë në kuadër të strukturës së kompanisë për të përfaqësuar metaforikisht “mendjen” e kompanisë, kryen një krim brenda detyrave të tij, ai veprim dhe *mens rea* mund t’i atribuohet kompanisë. Kompania mund të “identifikohet” me këto akte dhe të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë. Teoria e dështimit të menaxhimit do të përbënte një sjellje të tillë *“duke rënë shumë më poshtë se çfarë mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga kompania në këto rrethana”*. Në shikim të parë kjo duket të jetë jo më shumë se një zgjerim i teorisë së identifikimit. Në

29 Manual për trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve dhe autoriteteve të tjera ligjzbatuese, *“Hetimi dhe ndjekja e veprave penale që lidhen me pronësinë intelektuale në Shqipëri”*, përgatitur dhe përshtatur nga Prof.Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI, WIPO 2020, faqja 15.

30 Shih nenet 7-8 të Konventës së Nikozisë.

31 Neni 16 i Kodit Penal.

vend që të kërkojnë një dështim nga ana e një individi ose grupi individësh të rangut të lartë, shikon një “dështim menaxhimi”. Megjithatë, teoria vazhdon të përcaktojë dështimin e menaxhimit si “një dështim për të garantuar siguri në menaxhimin ose organizimin e aktiviteteve të kompanisë”.³²

2.4. Dënimet sipas Konventës së Nikozisë

Dënimi penal përmbush dy funksione të ndryshme, atë të parandalimit të përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale, për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo nga shtetasit që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale dhe në mënyrë që autori i veprës penale, pas kryerjes së dënimit, të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale³³. Sipas nenit 47 të Kodit Penal, në caktimin e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në këtë mënyrë gjykata gjatë dhënies së dënimit vlerëson se cili lloj dënimi është në përpjesëtim me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj. Kodi Penal shqiptar parashikon këto lloj dënimesh kryesore: me burgim të përjetshëm, me burgim dhe me gjobë³⁴.

Në ligjin e posaçëm shqiptar³⁵, për përgjegjësinë penale të personave juridikë, parashikohen si dënime kryesore për këto të fundit: gjoba dhe mbarimi i personit juridik, ndërsa si dënime plotësuese: a) mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik; b) vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar; c) ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike; ç) heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve; d) ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare; dh) heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve; e) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

Konventa e Nikozisë parashikon një parim udhëheqës në caktimin e dënimit për autorët që kanë kryer vepra kundër pasurisë kulturore. Dënimi duhet të jetë *efikas*, pra të ketë ndikim tek autori dhe të zbatohet; *proporcional*, mekanizmi i kryerjes së veprës të mbahet në konsideratë; *parandalues*, pra të ketë efekt tek të tretët, dhe të mbajë në konsideratë rrezikshmërinë e veprës së kryer, pavarësisht se subjekti i veprës është individ apo person juridik. Llojet e dënimeve që parashikon Konventa janë si rregull “*heqja e lirisë*”, e përkthyer në terminologjinë juridike penale shqiptare, “burgimi”, me përjashtim të rasteve kur vepra penale konsiston në këto rrethana fakti: a) është gërmuar në tokë ose nën ujë për të gjetur dhe hequr pasuri kulturore pa autorizimin e kërkuar nga ligji i shtetit ku është kryer gërmimi; b) pasuria kulturore e luajtshme është importuar në mënyrë të paligjshme sepse ka si burim një gërmim të paautorizuar nga shteti i ardhur; pasuria kulturore e luajtshme është importuar në mënyrë të paligjshme sepse ka si burim një eksportim të paautorizuar nga shteti i ardhur. Në këto raste, shtetet mund të caktojnë një dënim me gjobë. Sa i takon personave juridikë të gjendur fajtor për kryerjen e një veprë penale ndaj pasurisë trashëgimore, Konventa parashikon këto lloj dënimesh: a) përjashtimi i përkohshëm ose i përhershëm nga ushtrimi i veprimtarive tregtare; b) përjashtimi nga e drejta e marrjes së ndihmës ose përfitimeve publike; c) vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore; d) një urdhër gjyqësor likuidimi³⁶.

Sa më sipër, është e qartë se lidhur me llojet e dënimeve, ligjvënësi shqiptar parashikon ato që Konventa kërkon të jenë pjesë e së drejtës së brendshme. Ligjvënësit i mbetet si detyrë që të specifikojë llojin dhe masën e dënimit në minimum apo maksimum, për secilën vepër konkrete.

32 Artur Prenga, “Përgjegjësia penale e personave juridikë. Aspekte teorike dhe problematika gjyqësore”, *Punim diplome*, kandidat për magistrat profili gjyqtar, viti 2018, Biblioteka e Shkollës së Magjistraturës, faqja 71-76.

33 Vendim nr. 19, datë 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

34 Shih nenin 29 të Kodit Penal.

35 Shih nenet 9 -10 të Ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

36 Shih nenet 4, 5, 14 të Konventës së Nikozisë.

2.5. Rrethanat rënduese sipas Konventës së Nikozisë

Rrethanat rënduese janë faktorë të ndryshëm objektivë dhe subjektivë, që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të lartë ose më të ulët të veprës dhe të kryerësit të cilat ndikojnë në masën e dënimit³⁷, duke e bërë atë më të rëndë. Për rrjedhojë, duke qenë se ato cenojnë pozitën e të pandehurit, duke rënduar sanksionin ndaj tij, ndryshe nga rrethanat lehtësuese që janë joshteruese, ato duhet të jenë të parashikuara shprehimisht në ligj, në mënyrë që të zbatohen. Aktualisht, rrethanat rënduese parashikon në nenin 50 të Kodit Penal dhe janë ezauruese³⁸. Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike³⁹.

Neni 15 i Konventës së Nikozisë parashikon se në rastet kur shtetet nuk e kanë pjesë elemente përbërëse (cilësuese) të veprës penale, konsiderojnë rrethanë rënduese këto raste: a) *vepra penale është kryer nga persona që kanë shpërdoruar besimin e dhënë në cilësinë e tyre si profesionistë*. Në këtë rast, profesionistët mund të jenë ushtrues të profesioneve të lira, por që lidhen me artin, kulturën, trashëgiminë kulturore. Kështu, këta subjekte mund të kenë një licensë si koleksionist, organizues ekspozitash, muzeolog, menaxher marketingu i veprave të artit dhe kulturës; b) *vepra penale është kryer nga një zyrtar publik i ngarkuar me ruajtjen ose mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme ose të paluajtshme, nëse ai ose ajo nuk ka kryer qëllimisht siç duhet detyrat e tij ose të saj, me qëllimin për të siguruar përfitime personale të jashtëligjshme*. Në këtë rast, kjo rrethanë cilëson faktin dhe është vepër penale specifike, variant i krimit të përgjithshëm të “Shpërdorimit të detyrës”. Vepra kryhet me dashje dhe jo nga pakujdesia apo për shkak të mungesës së profesionalizmit. Kjo është arsyeja që hartuesi i konventës ka theksuar “nëse ai ose ajo nuk ka kryer qëllimisht siç duhet detyrat e tij ose të saj, për të siguruar përfitime personale të jashtëligjshme”.; c) *vepra penale është kryer në kuadër të një organizate kriminale*; Në këtë rast, do të ishte e nevojshme të provohej ekzistenca e organizatës kriminale, e më tej, kryerja e një prej veprave në dëm të pasurisë kulturore. Por, në rast se ligji parashikon se vetë fakti i qenies së një organizate kriminale përbën vepër penale në vetvete, nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese, për shkak të ndalimit të dënimit dy herë për të

37 Vendimi nr. 00-2024-1859 (282) datë 19.11.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

38 Neni 50 i Kodit Penal parashikon se: “Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë: a) kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta; b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një vepër penale tjetër ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material; c) kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori; ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë; ç/1) kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike; d) kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale; dh) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar; e) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen; e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje; f) kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera; f/1. Kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë, për shkak të detyrës. g) kur vepra është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes; gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim; h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë; i) kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive. j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”

39 Shih Vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

njëjtinfakt⁴⁰.; d) autori është dënuar më herët për veprat penale të përmendura në këtë Konventë. Kjo rrethanë ka parasysh recidivizmin, e cila kërkon recidivizëm specifik, pra të jetë kryer një nga veprat e vjedhjes, përvetësimit, importimit, eksportimit, gërmimit të paligjshëm, blerjes dhe vendosjes në treg.

Siç vihet re, rrethanat rënduese që parashikon Konventa e Nikozisë janë të detajuara dhe të orientuara në drejtim të interesit më të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Nga praktika gjyqësore, e çështjeve të referuara në këtë punim, vihet re se njohuritë profesionale në fushën e artit dhe kulturës, të autorëve të veprave penale, kanë lehtësuar kryerjen e veprave penale në këtë fushë nga ana e tyre, por kjo e dhënë, nuk mund të përdorej nga organi procedues në individualizimin e dënimit si rrethanë rënduese apo cilësuese, për shkak të mosparashikimit të saj shprehimisht në ligj. Për rrjedhojë, përjasja e rrethanave rënduese të përcaktuara në Konventë, në ligjin e brendshëm shqiptar, do të arrijë dy qëllime: parandalimin e kryerjes së veprave penale mbi pasuritë kulturore nga profesionistët e kësaj fushe dhe individualizimin korrekt të përgjegjësisë penale të autorit nga ana e gjykatës. Interpretimi gjyqësor është interpretimi i ligjit që bën gjykata kur zgjidh ndonjë çështje gjyqësore konkrete në të cilën zbatohet ky ligj.⁴¹

Përfundime dhe rekomandime

Punimi është një tentativë fillestare për të trajtuar përjasjen e legjislacionit shqiptar me Konventën e Këshillit të Evropës për Veprat penale që lidhen me pasuritë kulturore, të miratuar në Nikozi, në maj të vitit 2017. Konventa, është plotësuese e kuadrit juridik ndërkombëtar dhe zëvendëson projektin e papërfunduar të Konventës së vitit 1985 të Delf-it, prandaj mund të konsiderohet si Traktati i Vetëm Ndërkombëtar, i cili ka për objekt kriminalizimin e veprave penale që lidhen me trashëgiminë kulturore.

Aktualisht, kuadri ligjor shqiptar në lidhje me trashëgiminë kulturore në Shqipëri, është zhvilluar në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në organizma dhe akte ndërkombëtare të fokusuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Mbrojtja juridike konsiston në kriminalizimin e veprimeve apo mosveprime të rrezikshme shoqërisht, si dhe saksionimin e veprimeve apo mosveprimeve të tjera, më pak të rënda si kundërvajtje administrative, apo shkelje doganore. Në praktikë, numri i çështjeve të hetuara dhe gjykuara nuk është i kënaqshëm, dhe ende krimet në fushën e trashëgimisë kulturore nuk trajtohen si krime serioze, për nga shkalla e rrezikshmërisë së tyre.

Përpos përpjekjeve të ligjvënës, për të pasur një kuadër ligjor të plotë, nga praktika gjyqësore, siç është analizuar më poshtë, ka ende boshllëqe ligjore, të cilat duhet të plotësohen, detyrim që buron edhe nga Konventa e Nikozisë, pasi është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe ka epërsi mbi legjislacionin e brendshëm. Qëllimi parësor i Konventës së Nikozisë është:

- Të parandalojë dhe të luftojë shkatërrimin, dëmtimin dhe trafikimin e pasurive kulturore, duke parashikuar kriminalizimin e disa akteve,
- Të forcojë parandalimin e krimit dhe kundërpërgjigjen e drejtësisë penale për të gjitha veprat penale që lidhen me pasuritë kulturore;
- Të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në luftën kundër veprave penale që lidhen me pasuritë kulturore; dhe si rrjedhojë të mbrojë pasuritë kulturore.

40 Neni 333 i Kodit Penal parashikon ndër të tjera se: “Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet....”.

41 Sokol Berberi, “Ligjvënësi dhe interpretimi gjyqësor i ligjit”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, Numri3, Viti XV i botimit, Tiranë, shtator 2014, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “MORAVA”, faqja 9.

Hartuesit e Konventës janë treguar mjaftueshëm të kujdesshëm, duke përfshirë një kategori të gjerë veprash si pasuri kulturore, për dy arsye kryesore. Së pari, të mos krijohen kontradikta në kuadrin ligjor të shteteve palë në Konventë, dhe së dyti, të garantohet një mbrojtje sa më e gjerë e trashëgimisë kulturore.

Ligji i posaçëm shqiptar lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridikë që kryejnë vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore është një “prehër” i sigurt për Konventën e Nikozisë, pasi ofron një garanci më të lartë sesa vetë Konventa, ndaj, ligjvënësi shqiptar nuk ka detyrim që të ndërmarrë një nismë legjislative në këtë Konventë. Rrethanat rënduese që parashikon Konventa e Nikozisë janë të detajuara dhe të orientuara në drejtim të interesit më të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Për rrjedhojë, përjasja e rrethanave rënduese të përcaktuara në Konventë, në ligjin e brendshëm shqiptar, veçanërisht rrethana rënduese e autorit që ka njohuri profesionale në fushë, do të arrijë dy qëllime: parandalimin e kryerjes së veprave penale mbi pasuritë kulturore nga profesionistët e kësaj fushe dhe individualizimin korrekt të përgjegjësisë penale të autorit nga ana e gjykatës.

Së fundmi, Konventa e Nikozisë kërkon një vullnet të lartë të shteteve me njëra –tjetrën në rastin e hetimit dhe ndjekjes penale, si në aspektin e bashkëpunimit gjatë hetimeve paraprake, duke dakordësuar juridiksionin në ato raste kur pretendohet nga më shumë se një palë; në aspektin e ndihmës së ndërsjelltë juridike dhe ekstradimit e autorëve; dhënien fuqi vendimeve penale të formës së prerë të shqiptuara nga autoriteti gjyqësor i secilit shtet; kthimin e pasurisë kulturore në vendin e origjinës pas përfundimit të hetimeve. Ajo që duhet theksuar, është se Konventa, nuk pengon thellimin e bashkëpunimit midis shteteve në këtë fushë. Megjithatë, Konventa me fanatizëm lips një supremaci të saj në raport me instrumentat e tjerë që nënshkruajnë shtetet me njëra – tjetrën, duke përcaktuar se ujdite në akte të tjera duhet të jenë të atilla që të jenë me objektivat dhe parimet e Konventës.

Konventa kërkon gjithashtu që shtetet të marrin masat që të rrisin kapacitetet, njohuritë, aftësitë e praktikuesve të së drejtës lidhur me veprat penale në fushën e trashëgimisë kulturore. Në këtë drejtim, barra bie mbi organet kompetente të qeverisjes së drejtësisë (Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës) përgjegjës për zhvillimin profesional të magjistratëve

Referencat

Botime dhe artikuj shkencor

1. Aharon Barak, “Gjyqtari në demokraci”, Shtëpia botuese & shtypshkronja “Morava”, faqja 4.
2. Artur Prenga, “Përgjegjësia penale e personave juridikë. Aspekte teorike dhe problematika gjyqësore”, Punim diplome, kandidat për magjistrat profili gjyqtar, viti 2018, Biblioteka e Shkollës së Magjistraturës, faqja 71-76.
3. Artan Hoxha, “Ekstradimi dhe urdhri europian i ndalimit”, 2011, Shtëpia botuese “Morava”, faqja 28.
4. Sokol Berberi, “Arsyetimi dhe shkrimi ligjor”, Tiranë 2011, Shtypshkronja “MORAVA”, faqet 17-24.
5. Sokol Berberi, “Ligjvënësi dhe interpretimi gjyqësor i ligjit”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, Numri 3, Viti XV i botimit, Tiranë, shtator 2014, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “MORAVA”, faqja 9.
6. Jean Pradel, Geert Corstens, Gert Vermeulen, “E drejta penale evropiane”, 2009, Botimet Papirus, faqja 47.
7. Jonad Bara, “Interneti dhe krimi kibernetik”, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 3, Viti VIII i botimit, Tiranë, shtator 2010, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe

shtypshkronja “MORAVA”, faqja 95.

8. Kristaq Traja, *“Tipologjia e kuptimeve të së drejtës”*, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 2, Tiranë 2018, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “ONUFRI”, faqja 33.
9. Leonard F.M Besselink, *“Identiteti kombëtar dhe kushtetues para dhe pas Lisbonës”*, Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” Numri 4, Viti XV i botimit, Tiranë, dhjetor 2014, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “MORAVA”, faqja 135.
10. Mateusz Maria Bieczyński, *“The Nicosia Convention 2017: A New International Instrument Regarding Criminal Offences against Cultural Property”*, Santander Art and Culture Law Review 2/2017 (3): 255-274 DOI: 10.4467/2450050XSNR.17.017.8432, faqja 263. (Aksesuar më datë 14.01.2025 [SAACLR nr 2 2017 \(3\) 16 \(2\).pdf](#))
11. Beyeler kundër Italisë ([GC], nr. 33202/96, GJEDNJ 2000-I), paragrafi 113.
12. Manual për trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve dhe autoriteteve të tjera ligjzbatuese, *“Hetimi dhe ndjekja e veprave penale që lidhen me pronësinë intelektuale në Shqipëri”*, përgatitur dhe përshtatur nga Prof.Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI, WIPO 2020, faqja 15.
13. Naim Mëçalla, *“Pastrimi i parave, Elementët juridiko – penal dhe kriminologjik”*, Tiranë 2013, Shtëpia Botuese KLEAN, faqja 273.
14. Prof.Dr. Xhezair Zaganjori, *“Azili dhe ekstradimi ose ndjekja penale dhe persekutimi. Koncepte me rëndësi që krijojnë jo pak vështirësi në praktikën gjyqësore”*, Revista Juridike Shkencore, “Jeta Juridike” Numri 2, Tiranë 2018, Shkolla e Magjistraturës, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “ONUFRI”, faqja 15.

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 123/2024 *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprat Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore”*, bërë në Nikosia më 19.5.2017
3. Ligji Nr.9490, datë 13.3.2006 *“Për ratifikimin e Konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, Paris 2003”*); Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
4. Ligji nr.9806, datë 17.9.2007 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane për trashëgiminë arkeologjike”*.
5. Kodi Penal
6. Kodi Doganor
7. Ligji nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*
8. Ligji Nr.9754, datë 14.6.2007 *“Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”*.

Praktikë gjyqësore

1. Vendim nr. 31, datë 19.11.2003 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendim nr. 34, datë 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
3. Vendim nr. 19, datë 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
4. Vendim nr. 1, datë 11.01.2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
5. Vendim nr. 00-2024-1859 (282) datë 19.11.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
6. Vendim nr. 41-2010-3507, datë 27.09.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
7. Vendim nr. 62-2013-4495, datë 30.12.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
8. Vendim nr. 11-2014-1571, datë 02.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
9. Vendim nr.13-2015-1044, datë 19.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
10. Vendim nr. 13-2015-6585, datë 19.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
11. Vendim nr. 21-2016-992, datë 08.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
12. Vendim nr. 646 (62-2017-5620) datë 20.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
13. Vendim nr. 884, datë 15.04.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Burime nga web

1. *“Council of Europe Convention on offences relating to cultural property, CETS No. 221 and*

- explanatory report*”, Nicosia 19.V.2017, Council of Europe, March 2022 <https://rm.coe.int/council-of-europe-convention-on-offences-relating-to-cultural-property/1680a5dafb> (Aksesuar në datën 15.01.2025)
2. “*The Nicosia Convention in 10 questions and answers*”, botim i Këshillit të Evropës, Mars 2023, faqja 9. <https://rm.coe.int/the-nicosia-convention-in-10-questions-and-answers-/1680aae7f1> (Aksesuar në datën 14.01.2025)
 3. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2025> (Aksesuar në datën 14.01.2025)
 4. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatyenum=221> (Aksesuar në datën 14.01.2025)
 5. <https://www.coe.int/en/web/portal/46-members-states> (Aksesuar në datë 14.01.2025)
 6. [Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm](#) (Aksesuar në datën 13 Janar 2025)